



**RREGULLORE PËR  
PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS LOKALE TË TRANSMETIMIT  
AUDIOVIZIV NË PERIUDHËN TRANZITORE**

**(Miratuar me vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Nr. 100, datë 07.06.2017)**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënie të licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore, në zbatim të nenit 139 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 2  
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE-së dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive.
2. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
  - b. “Subjekt aplikues” është personi juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i krijuar nga bashkimi i operatorëve vendorë analogë me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive, i cili aplikon për marrjen e licencës lokale të transmetimit audioviziv dhe shërbimit të programit audioviziv.
  - c. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- d. "Programe në gjuhën shqipe" janë programe të transmetuara në gjuhën shqipe, përmes titrimit të programeve të huaja në gjuhën shqipe ose përshkrimit të tyre me zë në gjuhën shqipe.
- e. "Shërbimi mediatik audioviziv" është një shërbim nën përgjegjësinë editoriale të një operatori të shërbimit mediatik, qëllimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve informuese, argëtuese ose edukuese, për publikun e gjerë, nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik. Një shërbim i tillë mediatik audioviziv është ose një transmetim televiziv ose një shërbim mediatik audioviziv, sipas kërkesës dhe/ose një komunikim tregtar audioviziv, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
- f. "Shërbim programor i përgjithshëm" është shërbimi programor me përmbajtje të shumëllojshme, i cili mund të jetë kombëtar, rajonal ose lokal.
- g. "Shërbim programor tematik" është shërbimi programor që të paktën 70% të kohës së transmetimit ia dedikon përmbajtjeve mbi një tematikë të caktuar: informacion; të mitur; kulturë dhe shkencë; filma; sport; shqip; muzikë, etj.
- h. "Shërbim programor për të mitur" është shërbimi programor tematik me përmbajtje që i dedikohen grupmoshës deri në 18 vjeç, me qëllim, informimin, edukimin dhe argëtimin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre.
- i. "Shërbim programor informativ" është shërbimi programor tematik me përmbajtje dedikuar informacionit, me lajme, rubrika të aktualitetit, kronika, reportazhe, debate dhe lidhje të drejtpërdrejta, biseda apo forume mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit social, ekonomik, politik, kulturor etj.
- j. "Shërbim programor kulturë dhe shkencë" është shërbimi programor tematik me përmbajtje edukative, historike, artistike, letrare ose shkencore, dokumentarë dhe emisione të aktualitetit shkencor dhe teknologjik, me karakter argëtues, vepra audiovizive evropiane, pjesë teatrale, lirike etj.
- k. "Shërbim programor film" është shërbimi programor tematik i dedikuar për transmetimin e filmave artistikë, televizivë, seriale, etj.
- l. "Shërbim programor muzikë" është shërbimi programor tematik i dedikuar të gjitha rrymave krijuese e interpretuese, me përmbajtje të regjistruara ose live, informacion dhe diskutime mbi ngjarje muzikore nga vendi e bota etj.
- m. "Shërbim programor sport" është shërbimi programor tematik i dedikuar sportit, me ngjarje lokale, lokale dhe ndërlokale të transmetuara direkt ose të regjistruara, lajme dhe emisione diskutimesh nga zhvillime të ndryshme sportive.
- n. "Shërbim programor shqip" është shërbimi programor tematik me programe tërësisht në gjuhën shqipe, për nxitjen dhe promovimin e gjuhës e kulturës lokale, si filma, dokumentarë, përmbajtje zbavitëse e argëtuese etj.
- o. "Shërbim programor teleshitje" është shërbimi programor tematik që përbën një ofertë të drejtpërdrejtë për publikun për shitjen apo sigurimin e mallrave, shërbimeve ose pasurive të tjera të paluajtshme apo pronësisë intelektuale.
- p. "Shërbime të reja shoqëruese" janë shërbimet që ofrohen si pasojë e zhvillimeve të reja teknologjike, si: PVR, PVOD, Catch-Up, Time Shifting, EPG/Audio/Titra shumë gjuhësore, përditësime OTA, etj.



- q. “Udhëzuesi elektronik i programit” është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.

### Neni 3 Baza Ligjore

1. Licencimi sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar në këtë rregullore bazohet në aktet e mëposhtme ligjore:
  - a. Ligji nr. 9851, datë 26.12.2007, “Për ratifikimin e akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) dhe të akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (RRC-06 REV. ST 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj - 16 qershor 2006.
  - b. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 139, pika 4/a/ii.
  - c. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”.
  - d. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017, “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”.

### Neni 4 Llojet e licencave

1. Licenca lokale e transmetimit audioviziv përbëhet nga:
  - a) Licencë të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
  - b) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të rrjeteve numerike tokësore lokale në teknologjinë DVBT-2, me standardin e kompresionit MPEG-4.
2. Licenca lokale e transmetimit audioviziv do të jepet për ofrimin e shërbimit të progamit audioviziv brenda një zone të planifikuar për t’u mbuluar nga një rrjet SFN.

### Neni 5 Marrëveshja e Operatorëve analogë vendorë

1. Në procesin e licencimit të rrjeteve numerike private lokale brenda një zone të planifikuar për t’u mbuluar nga një rrjet SFN, ftohen të marrin pjesë operatorët vendorë analogë



- ekzistues, të licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv në zonën përkatëse.
2. Të paktën 70% e subjekteve të licencuar si operatorë vendorë analogë brenda një allotmenti ekzistues të licencuar duhet të lidhin marrëveshje me anë të së cilës bien dakord për ndërtimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit numerik. Në këtë rast, subjektet ekzistues do të krijojnë një shoqëri tregtare, ortakë të të së cilës do të jenë subjektet ekzistues (shoqëri apo persona fizikë), shoqëri të cilës do t'i akordohet licenca e rrjetit numerik lokal.
  3. Programet analoge vendore private të licencuara sipas legjislacioni në fuqi do të transmetohen hapur edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.
  4. Në një rrjet numerik lokal, jo më pak se 10% të kapacitetit të rrjetit (programe të veta dhe të të tretëve) do të përdoret për të mbështetur programet e hapura.

### Neni 6

#### Karakteristikat e rrjeteve lokale private numerike dhe struktura e shërbimeve të programeve që mbështeten në to

1. Rrjetet private numerike lokale, subjekt i procedurës së licencimit sipas kësaj rregulloreje kanë karakteristikat e mëposhtme:

Teknologjia	DVB-T2
Sistemi i Kodimit (standardi i kompresimit)	MPEG-4
Gjerësia e bandës	8 MHz
Brezi i frekuencave	470-790 MHz
Teknologjia	DVB-T2
Sistemi i Kodimit	MPEG-4
Cilësia e transmetimit	SD/HD

2. Struktura e shërbimeve të programeve që do të mbështeten në rrjetet lokale private numerike ka përbërjen e mëposhtme:

	KARAKTERI I PROGRAMIT	PROGRAME TE VETA
1	Përgjithshëm	Jo më pak se 1 program
2	Të mitur	Jo më pak se 1 program
3	Sport	Jo më pak se 1 program
4	Filma	Jo më pak se 1 program
5	Shqip	Jo më pak se 1 program



3. Përveç programeve të sipërpërmendura, subjekti aplikues ka të drejtë të mbështesin në rrjetin numerik dhe programet e veta të mëposhtme:

KARAKTERI I PROGRAMIT	
1	Program informativ
2	Program për të rritur
3	Program kulturë dhe shkencë
4	Program mode
5	Program sipas kërkesës
6	Teleshitje
7	Program reality show
8	Muzikë
9	Programe të tjera

## Neni 7 Shfrytëzimi i rrjeteve

1. Subjekti i cili do të licençohet për transmetime numerike lokale audiovizive, ka të drejtë të shfrytëzojë deri në 60 për qind të kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta.

2. Subjekti që do të licençohet për transmetime numerike lokale audiovizive është i detyruar t'i japë akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese, në jo më pak se 40 % të kapacitetit të rrjetit numerik të tij, OSHMA-ve që zotërojnë licencë lokale shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv. Kushtet e shfrytëzimit të jo më pak se 40% të kapacitetit të rrjetit numerik, në rast të mungesës së kërkesë nga OSHMA-të, do të rregullohet me vendim të veçantë të AMA të marrë më shumicë të cilësuar të anëtarëve të tij.

3. Mbjtësit e licencave lokale numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Çdo kontratë e lidhur midis mbajtësit të licencës lokale numerike të transmetimit audioviziv dhe OSHMA-ve duhet të depozitohet në AMA brenda 30 ditësh nga data e nënshkrimit. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.

4. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave lokale numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.



5. Në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave lokale të transmetimeve numerike audiovizive, palët i drejtohen AMA-s.

## KREU II

Page | 6

### LICENCIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE NUMERIKE DHE SHËRBIM PROGRAMI AUDIOVIZIV

#### Seksioni I

#### Kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv dhe shërbim programi audioviziv

##### Neni 8

#### Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë lokale të transmetimit audioviziv dhe shërbim programi audioviziv

1. Licenca lokale e transmetimit audioviziv i jepet personit juridik të krijuar nga bashkimi i të paktën 70 % të subjekteve të licencuar si operatorë vendorë analogë brenda një allotmenti ekzistues, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt veprimtarinë audiovizive.
2. Operatori ekzistues i licencuar për transmetime analoge rajonale, ka të drejtë të jetë ortak në 4 subjekte audiovizivë që do të pajisen me licencë lokale transmetimi në zonat ku subjekti kryen transmetim analog, në çdo rast duke respektuar kufizimet e parashikuara në pikën 2 të nenit 63 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi numrin e programeve.
3. Licenca lokale e transmetimit audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.
4. Licenca lokale e transmetimit audioviziv nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë epavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur iu është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca.

##### Neni 9

#### Kërkesat financiare



1. Licenca lokale e transmetimit audioviziv u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Lokale të Biznesit, në vlerën jo më pak 3.500.000 lekë.
2. Subjekti aplikues duhet të paraqesë garanci bankare në masën e pagesës vjetore të miratuar nga AMA për këtë lloj licence. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 12 mujore duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit.
3. Garancia bankare ç`ngurtësohet menjëherë, para afatit, në rast se subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë.
4. Në rast se aplikuesi pajiset me licencë, vlera e ngurtësuar kalon menjëherë për llogari të AMA-s si pagesë për vitin e parë të licencimit.

### **Neni 10**

#### **Kërkesat programore**

1. Subjekti aplikues për licencë lokale të transmetimit audioviziv për programet e veta duhet të garantojë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tij do të përmbushin standardet programore duke:

- a. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit.
- b. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinioneve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
- c. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
- d. Promovuar kulturën lokale shqiptare dhe gjuhën shqipe;
- e. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t`u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane;
- f. Promovuar kulturën e pakicave lokale;
- g. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, shfaqjeve teatrore dhe sidomos ato të lidhura me kulturën lokale;
- h. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e Republikës së Shqipërisë për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
- i. Promovuar bashkëpronësinë dhe kolegjalitetin në vendimmarrjet editoriale;
- j. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
- k. Respektuar privatësinë e individit;
- l. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;
- m. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;



- n. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;
- o. Respektuar të drejtën e përgjigjes.

### **Neni 11** **Kërkesat teknike**

1. Subjekti aplikues për licencë lokale të transmetimit audioviziv duhet të plotësojë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:
  - a. Planin e frekuencave të rrjetit lokal, të miratuar nga AMA bazuar në Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve “Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007;
  - b. Standardet e transmetimit;
  - c. Pikat e transmetimit dhe fuqitë përkatëse të rrezatuara që përcaktojnë zonën e mbulimit;
  - d. Shërbimet e reja;
  - e. Teknologjinë e transmetimit;
2. Aplikuesi për licencë lokale të shërbimit të programit audioviziv duhet të plotësojë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:
  - a. Standardet e prodhimit;
  - b. Teknologjinë e prodhimit;
  - c. Afatin e daljes në transmetim të programit;

## **Seksion II**

### **Procedura e dorëzimit të aplikimeve**

#### **Neni 12**

##### **Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e licencimit**

1. AMA fton subjektet televizivë privatë vendorë analogë të aplikojnë për marrjen e një licence lokale të transmetimit audioviziv të përbërë nga:
  - a) Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
  - b) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të rjeteve numerike tokësore lokale në teknologjinë DVBT-2, me standartin e kompresionit MPEG-4.
2. AMA miraton dokumentacionin e licencimit të dhënies së licencës së rrjeteve numerike private lokale.
3. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga marrja e ftesës.





4. Aplikimet duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

### **Neni 13**

#### **Njoftimi i procedurës së licencimit të rrjeteve numerike private lokale**

Page | 9

Njoftimi për organizimin e procedurës së licencimit të rrjeteve numerike private lokale publikohet në faqen zyrtare të AMA-s, në të paktën 3 gazeta të përditshme me tirazhin më të lartë, për të paktën 3 ditë rradhazi.

### **Neni 14**

#### **Kushtet e pjesëmarrjes në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike private lokale**

1. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike private lokale jep informacion për procedurën, qëllimin e saj dhe dokumentacionin e aplikimit.
2. Subjektet e ftuara nga AMA, për të marrë pjesë në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike private lokale, duhet:
  - a. Të përfundojnë marrëveshjen e përbashkët për ndërtimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit numerik privat lokal, duke regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit shoqërinë e përbashkët.
  - b. Secili operator vendor analog ekzistues të shlyejë detyrimet financiare ndaj AMA-s dhe buxhetit të shtetit;
3. Shoqëria e përbashkët e krijuar nga bashkimi i subjekteve ekzituese duhet:
  - a. të tërheqë kundrejt pagesës dokumentacionin e miratuar për këtë procedurë;
  - b. Të paraqesë aplikim in në vendin, kohën dhe formën e specifikuar në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike private lokale;
  - c. të përcaktojë adresën e saktë për korrespondencë zyrtare.
3. Në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike private lokale do të përcaktohet vendi dhe afati përfundimtar për tërheqjen e dokumentacionit.

### **Neni 15**

#### **Tërheqja e dokumentacionit**

1. Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë transmetimi audiovizive numerike dhe/ose licencë të shërbimit të programit audioviziv duhet të pajisen me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesin aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e licencimit.



2. Drejtoritë e AMA-s, përgatisin dokumentacionin që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do shfaqin interes për t'u licencuar, i cili mund të tërhiqet prej tyre pranë zyrës së protokollit të AMA.

### **Neni 16**

#### **Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit**

Page | 10

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet e që kanë blerë dokumentacionin e licencimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.

2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

### **Neni 17**

#### **Aplikimi**

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit dhe modelit të miratuar nga AMA, që do të jetë pjesë e dokumentacionit të licencimit.
2. Subjekti aplikues plotëson vetëm hapësirat e modelit të përcaktuara për t'u plotësuar me të dhëna. Subjekti aplikues nuk duhet të bëjnë asnjë ndryshim në përmbajtjen e modelit të miratuar.
3. Dokumentacioni i aplikimit që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë përpara datës së aplikimit.
4. Aplikimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
5. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.

### **Neni 18**

#### **Dokumentacioni i aplikimit**

1. Subjekti aplikues për licencë lokale të transmetimit audioviziv që do t'i nënshtrohet procedurës së licencimit të rrjeteve lokale të transmetimit audioviziv, duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

##### **1.1 Të dhënat e aplikuesit:**

- a. Regjistrimi në QKB me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionerëve me kuotat respektive;



- b. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë listën e ortakëve të tij;
- c. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve/ortakëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera me veprimtari audio ose audiovizive;
- d. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të subjektit;
- e. Adresa, nr. tel, fax, e\_d. mail;
- f. Personi përfaqësues;
- g. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.

#### 1.2 Kërkesa teknike:

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
- b. Projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor.
- c. Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipin dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit
- e. Projektin e studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios
- f. Treguesit e cilësisë së shërbimit, kualiteti i mbulimit dhe cilësia e programeve nga pikëpamja teknologjike, shërbimet e reja shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.
- g. Plani i mirëmbajtjes së rrjetit duke përfshirë masat për sigurimin e vazhdimësisë së transmetimeve në raste të shkëputjes së energjisë apo defekteve teknike të mundshme.

#### 1.3 Kërkesat ekonomike:

- a. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pasqyruar dhe i depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- b. Biznes plani me treguesit e tij dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës; (a. përshkrimi i shoqërisë, b. analiza e tregut, c. strategjia e marketingut, d. burimet e financimit dhe objektivat financiare);
- c. Garancia bankare.
- d. Lista e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca.

#### 1.4 Kërkesat programore:

- a. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen dhe struktura programore e propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit;



- b. Të paktën 40% të kohës së përgjithshme të transmetimit ia kushtojnë problematikës lokale;
- c. Të dhëna statistikore për programet audiovizive të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe të tematizuar (informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, ekranizime, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- d. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- e. Programi javor i transmetimit
- f. Përshkrimi i përmbajtjes i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë;
- g. Depozitimi i marrëveshjeve të lidhura me mbajtësit e të drejtave të programeve që do të transmetohen.

#### 1.5 Të tjera:

- a. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve të siguruar të aplikuesit si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për 12 muajt e fundit nga paraqitja e aplikimit;
  - b. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë(organigrama), lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues (të paktën 5 anëtarë), përgjegjës për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet të kenë eksperiencë në fusha të tilla si media e komunikim, inxhinieri, financë ose si aktivistë të shoqërisë civile.
2. Subjekti aplikues për licencë lokale të shërbimit të programit audioviziv, duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara pikat 1.1, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, si dhe kërkesat e mëposhtme teknike:
    - a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit.
    - b. Projektin e studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios.
    - c. Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit
    - d. Afatin e daljes në transmetim.
    - e. Treguesit e cilësisë së shërbimit (SD, HD, etj.)
    - f. Shërbimet e reja shoqëruese
  3. AMA ka të drejtë të kërkojë nga aplikuesi informacion shtesë lidhur me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e aplikimit.
  4. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.



**Seksioni III**  
**Shqyrtimi dhe vendimmarrja mbi aplikimet**

**Neni 19**  
**Shqyrtimi i aplikimeve**

1. Shqyrtimi i aplikimeve për marrje licence kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, i ngritur me urdhër të kryetarit të AMA-s.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit përbëhet si më poshtë:
  - Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Licencave
  - Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit
  - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme
  - Drejtori i Drejtorisë të Programeve
  - Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
  - Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes
3. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit drejtohen nga Zv/Kryetari i AMA, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, pa të drejtë vote, me pjesëmarrjen e të paktën një prej anëtarëve të AMA-s.
5. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë dhe verifikojnë përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, teknike, programore, strukturore dhe përgatitjen e relacionet e vlerësimit sipas kompetencës.
6. AMA miraton procedurat e ndjekura. AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave dhe vlerësimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
7. Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.
8. Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

**Neni 20**  
**Vendimmarrja**



1. Vendimi për dhënie ose mosdhënie e licencës së transmetimit audioviziv ose shërbimit të programit audioviziv jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit.

2. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:

- a) arsyet e vendimit;
- b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;
- c) rezultatin e aplikimit fitues.

3. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative duke filluar ky afat nga momenti i marrjes dijeni.

### KREU III

#### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 21

##### Shërbimet pa pagesë (free-to-air)

I licencuari për transmetim audioviziv lokal siguron që të gjithë dekodert që ofron vetë në shitje të kenë aftësinë të marrin dhe shfaqin transmetimet e hapura (free-to-air) të të gjithë rrjeteve numerike kombëtare, rajonale dhe lokale në një zonë të caktuar. Udhëzuesi elektronik i programeve i inkorporuar në këta dekodere siguron që shërbimet e hapura të shfaqen në ekran dhe të zgjidhen nga shikuesit pa i detyruar ata të paguajnë ndonjë tarifë. Informacionet që shfaqen në Udhëzuesin Elektronik të Programeve duhet të jenë në gjuhën shqipe.

#### Neni 22

##### Afat i licencës

Licenca lokale numerike e transmetimit audioviziv jepet për një afat 8 vjeçar.

#### Neni 23

##### Detyrimi për daljen në transmetim dhe mbulimi

1. I licencuari për transmetim audioviziv lokal duhet të respektojë kërkesën e parashikuar në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, për daljen në transmetim



## Neni 24 Detyrimet financiare

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audioviziv lokal do të kryhen bazuar në vendimet e Autoritetit të Mediave Audiovizive, nr. 04, datë 22.05.2013 “Për miratimin e pagesave për licencë”, i ndryshuar dhe nr. 210, datë 16.09.2016 “Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga AMA”, i ndryshuar.
2. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamat vonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

## Neni 25 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.



**ANEKSI 1**  
**FORMULAR APLIKIMI**

**PËR MARRJEN E LICENCËS LOKALE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV**

**Seksioni 1 Përfaqësimi**

<b>Emri i subjektit</b>	
<b>Adresa postare</b>	
<b>Telefon</b>	
<b>Fax</b>	
<b>Email</b>	

Bazuar në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e licencimit për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv, miratuar nga AMA me vendimin nr. ...., datë .....2016 më poshtë, në emër të shoqërisë \_\_\_\_\_, paraqes aplikimin e plotësuar për marrjen e licencës lokale të transmetimit audioviziv, të përbërë nga:

- Licenca të shërbimit të programeve audiovizive të veta;
- Licencë për ndërtimin e operimin e një rrjeti numerik tokësor lokal në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerësi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standartin e kompresionit MPEG-4.

Deklaroj se njoh dhe pranoj kërkesat e nenit 139 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar mbi licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, dhe kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 07.06.2017 të AMA-s.

**Në emër të shoqërisë \_\_\_\_\_, paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:**

**I. Kërkesat ligjore**

Tabela nr. 1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/Jo
1.	Ekstrakti i thjeshtë për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Bashkëlidhur)	
2.	Ekstrakti historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Bashkëlidhur)	
3.	Ekstrakti i thjeshtë i personit juridik nga Qendra Kombëtare e Biznesit nëse njëri nga ortakët e shoqërisë aplikuese është person juridik (Nëse aplikohet bashkëlidhur)	
4.	Ekstrakti historik i personit juridik nga Qendra Kombëtare e Biznesit nëse njëri nga ortakët e shoqërisë aplikuese është person juridik (Nëse aplikohet bashkëlidhur)	
5.	Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera me veprimtari audio ose audiovizive.	
7.	Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionerëve të subjektit (Bashkëlidhur)	
8.	Adresa, nr. tel, fax, mail (Bashkëlidhur)	
9.	Personi përfaqësues (Bashkëlidhur akti i përfaqësimit nëse aplikohet)	
10.	Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura	

Page | 17

## II. Kërkesat teknike

Tabela nr. 2

Nr	Dokumentacioni i kërkuar	Nr i fletëve të dokumentit të dorëzuar
1.	Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2.	Projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit , mënyrën e marrjes se sinjalit audiovizive si dhe dërgimin tek përdoruesi fundor.	
2.1	Projekti teknik duhet të jetë i detajuar dhe të përfshijë ndër të tjera karakteristikat teknike të stacioneve transmetues (si frekuencën qendrore të transmetimit, koordinatat e vendndodhjes, lartësinë mbi nivelin e detit, etj.), karakteristikat teknike te transmetimit (si tipin e modulimit, fuqinë efektive te rrezatuar, guard intervalin, code rate, bandëidth etj.) dhe karakteristikat teknike te antenave ( drejtimin e antenës, përforcimin, polarizimin, humbjet, fuqinë maksimale efektive te rrezatuar, azimuthin, lartësinë mbi nivelin e tokës, lartësinë mbi nivelin e detit, lartësinë maksimale efektive, tiltin, diagramat e antenave (paternns )etj.). Aplikuesi gjithashtu duhet te paraqesë mbulimin me sinjal te çdo allotmenti duke përcaktuar parametrat e përdorur për matjet e këtij mbulimi si dhe paraqitjen skematike te interferencave te brendshme dhe te jashtme. Në rastin e përdorimit të lidhjeve fikse, të paraqitet projekti i rrjetit të lidhjeve fikse, frekuencat e të cilave nuk administrohen nga AMA (administrohen nga AKEP).	
3.	Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipin dhe karakteristikat teknike të tyre.	
4.	Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit. Fazat e implementimit duhen të paraqiten në baze 3 (tre mujore) duke specifikuar numrin e transmetuesve që do të vendosen në punë dhe vendndodhjen e tyre (piken e transmetimit).	
5.	Projektin e studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios.	
6.	Treguesit e cilësisë së shërbimit, kualiteti i mbulimit dhe cilësia e programeve nga pikëpamja teknologjike, shërbimet e reja shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.	
7.	Plani i mirëmbajtjes së rrjetit duke përfshirë masat për sigurimin e vazhdimësisë së transmetimeve në raste të shkëputjes së energjisë apo defekteve teknike të mundshme.	

Nr	Të dhëna të tjera teknike	Nr i fletëve të dokumentit të dorëzuar
1.	Afati i daljes në transmetim:	
2.	Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet (HD/SD)	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

	2.1 Numri i programeve HD	
	2.2 Numri i programeve SD	
3.	Numri i shërbimeve të reja (PVR, PVOD, Interaktiv, Multilanguage EPG/Audio/Subtitles, OTA upgrade)	
4.	Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve	
5.	Plani i mirëmbajtjes së rrjetit transmetues dhe shërbimi i kujdesit ndaj klientit.	
	5.1 Numri i punonjësve të angazhuar në mirëmbajtjen e rrjetit transmetues dhe shërbimit të kujdesit ndaj klientit. Kontratat në rast se ky shërbim kryhet nga nënkontraktor	

19

### III. Kërkesat ekonomike

Tabela Nr. 3

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/jo
1.	Kapitali i shoqërisë, pasqyruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
2.	Biznes plani me treguesit e tij dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës	
3.	Garancia bankare (Bashkëlidhur)	
4.	Lista e administratorëve (Bashkëlidhur informacioni)	
5.	Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimit për kohëzgjatjen e licencës (Tabela 3.2)	

*Fuqia ekonomike që rezulton nga kapitali themeltar i aplikantit*

Tabela Nr. 3.1

	Mijë lekë
Kapitali i trupëzuar	
Likuiditete të ngurtësuar	

*Plani për të ardhurat e shpenzimet gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tabela Nr 3.2

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet e vlefshmerisë	
			4 vjeçari I	4 vjeçari II
	<b>I. Të ardhurat</b>			
a.	Të ardhura nga kontratat dhe shërbimet për të tretët	000/lekë		
b.	Të ardhura nga sponsorizime, financime etj.	000/lekë		
c.	Të ardhura nga shitja e dekoderave	000/lekë		
d.	Të ardhurat nga reklamat	000/lekë		
dh.	Të ardhura nga abonentët	000/lekë		
e.	Të ardhura të tjera	000/lekë		
	<b>Totali i të ardhurave</b>	000/lekë		
	<b>II . Shpenzime</b>			
	<b>1. Shpenzime materiale e të tjera</b>			
a.	Shpenzime për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit	000/lekë		
b.	Shpenzime për përpunimin teknik të programeve	000/lekë		
c.	Shpenzime për energji elektrike, karburant, ngrohje	000/lekë		
d.	Shpenzime për qera	000/lekë		
e.	Shpenzime për taksa e tatime direkte e indirekte	000/lekë		
	<b>Shuma</b>	<b>000/lekë</b>		
	<b>2. Shpenzime për paga e sigurime shoqërore</b>			
a.	Fond page për të punësuar me kohë të plotë	000/lekë		
b.	Fond page për të punësuar me honorare	000/lekë		
	<b>Shuma</b>	000/lekë		
	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>000/lekë</b>		
	<b>Fitimi bruto</b>	<b>000/lekë</b>		
	<b>III. Punonjës gjithsej</b>	nr.		
a.	Stafi krijues	nr.		
b.	Stafi inxhiniero-teknik	nr.		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

c.	Administrata	nr.		
	<b>IV. Investimet</b>			
a.	Investime për pajisje të reja	000/lekë		
b.	Investime për rinovim teknologjie	000/lekë		
c.	Investime për kualifikimin e punonjësve	000/lekë		
	<b>Shuma</b>	000/lekë		
	<b>Burimi i Financimit:</b>			
a.	Fitimi i realizuar dhe i akumuluar	000/lekë		
b.	Kontributi i ortakëve	000/lekë		
c.	Hua nga të tretë	000/lekë		
	<b>Shuma</b>	000/lekë		

Page | 21

*Shënim: Aplikuesi duhet të paraqesë planin e të ardhurave e shpenzimeve për të gjithë vitet e licencimit.*

**Çmimi i ofruar për mbështetjen e të tretëve në rrjet**

Tabela Nr. 3.3

Pagesa e përcaktuar për mbështetjen e OSHMA-ve të tretë në rrjetin numerik.

- Pagesa për program audioviziv SD \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për program audioviziv HD \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për program audio \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar \_\_\_\_\_ lekë

**Çmimet për përdoruesit e shërbimeve audiovizive:**

1. Çmimet e shitjes së dekoderit bazë \_\_\_\_\_ lekë

2. Çmimet e paketave programore:

2.1. \_\_\_\_\_

2.2. \_\_\_\_\_

2.3. \_\_\_\_\_

2.4. \_\_\_\_\_



2.n. \_\_\_\_\_

#### IV. Kërkesat mbi programet

Page | 22

4. Ofrimi i programeve audiovizive duke respektuar të drejtën për informacion dhe pluralizëm, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, sidomos për mbrojtjen e të miturve etj., përmbajtja e të cilave duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit, si më poshtë:

##### 4.1. Përdorimi i gjuhës së shenjave

4.1.1 Përqindja e kohës së transmetimit me përdorimin e gjuhës së shenjave në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit.

\_\_\_\_\_

4.1.2. Përqindja e programeve ku do të përdoret gjuha e shenjave në raport me numrin e përgjithshëm të programeve.

\_\_\_\_\_

##### 4.2. Shërbimet e teletekstit që do të ofrohen.

\_\_\_\_\_

Alternativat e transmetimit të programeve në gjuhë të huaj:

4.2.1 Përqindja e programeve që do të transmetohen të titruara dhe dubluara me mundësi zgjedhje nga përdoruesit.

\_\_\_\_\_

4.2.2 Përqindja e programeve që do të transmetohen vetëm të titruara.

\_\_\_\_\_

4.2.3 Përqindja e programeve që do të transmetohen vetëm të dubluara.

\_\_\_\_\_

4.4. Paraqitja e masave të propozuara për të siguruar mbrojtjen e të miturve në rast transmetimi të programeve pornografike.

##### 4.5. Shërbimet e mbrojtura

Të dhënat mbi sistemin e aksesit të kushtëzuar përfshirë udhëzuesin elektronik të programeve.



- 4.5.1. \_\_\_\_\_  
4.5.2. \_\_\_\_\_  
4.5.3. \_\_\_\_\_  
4.5.4. \_\_\_\_\_

#### IV. Kërkesa të tjera

Tabela nr. 1

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/Jo
1.	Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për periudhën 12 muaj nga paraqitja e aplikimit (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
2.	Deklaratë noteriale mbi interesat financiare në subjekte që ushtrojnë veprimtari audio dhe/audiovizive (Nëse aplikohet, bashkëlidhur)	
3.	Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionerëve të saj (Bashkëlidhur)	
4.	Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë,(organigrama), lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues (të paktën 5 anëtarë), përgjegjës për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet të kenë eksperiencë në fusha të tilla si media e komunikim, inxhinieri, financë ose si aktivistë të shoqërisë civile.	